



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 18.8.2023

Nr: 29

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

“PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE DHE TË MONITORËVE PËR SHFAQJEN E FLETËVE TË VOTIMIT NË VENDIN E NUMËRIMIT TË VOTAVE, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 186, datë 11.8.2023, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës”, të nenit 20, pika 2, shkronja “c”, nenit 22, pika 2, nenit 23, pika 1, nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në vendin e numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.
2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga vendi i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.
3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga vendi i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ të Komisionit Rregullator.

Data: 18.8.2023 Nr: 29
Ora: 11:00



“Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendin e numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”

4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar